

Ceremonia e Hapjes

Përshkrimi i aktivitetit

Kjo ceremoni ka për qëllim prezantimin e metodologjisë për palët e përfshira në këtë projekt dhe t'u sigurojë atyre një program të detajuar të aktiviteteve. Sjellja e ekspertëve dhe përfaqësuesve institucionalë nga dy Shtetet Anëtare dhe Vendi Përfitues, do të sigurojë një mobilizim të brendshëm të aktorëve të projektit, si dhe një ekspozim të projektit të binjakëzimit.

Pritshmëria:

Finalizimi i programit të aktiviteteve dhe kalendari i projektit.

Përcaktimi i metodologjisë së punës përshtatur për secilin aktivitet.

Ceremonia e Mbylljes

Përshkrimi i aktivitetit

Kjo konferencë, e cila do të zhvillohet në muajin e fundit të projektit të binjakëzimit, do t'i lejojë palët e përfshira në këtë projekt të informohen si dhe do të vlerësohen rezultatet e arritura gjatë zbatimit të tij; gjithashtu do të diskutohet mbi perspektivat e "post-binjakëzimit" për sistemin përmbartimor shqiptar.

Pritshmëria:

Vlerësimi i rezultateve të projektit.

Kalendari tregues i aktiviteteve të post- projektit.

Kalendari: 18 muaj

REZULTATI 1. KAPACITETET E QËNDRUESHME TË SISTEMIT PËRMBARIMOR SHQIPTAR

PËRBËRËSI 1: FORCIMI DHE RACIONALIZMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE

Aktiviteti 1.1: Zgjerimi i kapaciteteve administrative të Ministrisë së Drejtësisë për të menaxhuar dhe rregulluar sistemin përmbartimor.

Përshkrimi i aktivitetit:

Një audit nga sistemi administrativ aktual i Ministrisë së Drejtësisë do të ngarkohet për të menaxhuar dhe rregulluar sistemin e përmbartimit (përfshirë ekzekutimin e

vendimeve të Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në të cilat shteti është debitor), si dhe do të vlerësojë nevojat dhe do të identifikojë dobësitë e sistemit. Së pari, do të vlerësohet roli i Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përmbartimit Shtetëror, Dhomës së Përmbartuesve Privatë dhe sistemit gjyqësor, pastaj fokusi do të zhvendoset në ndërveprimin midis tyre dhe tek roli i Ministrisë së Drejtësisë në koordinimin e sistemeve përmbartimore (organizimi, funksionimi, monitorimi dhe përdorimi i fondeve) dhe nëpunësve publikë.

Rekomandimet do të përmbledhen në draft dhe do t'i dërgohen Ministrisë së Drejtësisë për të bërë komentet.

Do të organizohet një tryezë e rrumbullakët për të paraqitur rekomandimet e palëve të ndryshme të interesuara dhe për të marrë miratimin e tyre.

Kalendari: Muajt 1-5, 8-9

Aktiviteti 1.2. Zgjerimi i kapaciteteve administrative të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave për të identifikuar pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Përshkrimi i aktivitetit:

Do të kryhet një analizë e gjithë sistemit ekzistues të identifikimit të pasurive, në mënyrë që të vlerësohet efikasiteti i sistemit përmbartimor ekzistues.

Bazuar në këtë analizë, do të bëhen rekomandime për:

1. Forcimin e kapaciteteve administrative të të dy ministrive për të menaxhuar sistemet e përmbartimit;
2. Forcimin e shkëmbimit të informacionit midis dy ministrive për sa u përket këtyre çështjeve.

Do të organizohet një tryezë e rrumbullakët për të paraqitur rekomandimet e palëve të ndryshme të interesuara dhe për të marrë miratimin e tyre.

Kalendari: muajt 6-7, 8-9

Aktiviteti 1.3: Përmirësimi i ngritjes së brendshme ligjore, organizative dhe institucionale të Dhomës Kombëtare të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë.

Përshkrimi i aktivitetit:

Do të rishikohet analiza e gjithë dokumentacionit ligjor, rregullores së brendshme (ligji material, etika, disiplina etj) e Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë.

Do të mbahet një vlerësim i mjeteve financiare dhe burimeve njerëzore të Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë. (rezultatet e këtij vlerësimi do të përdoren në aktivitetin 1.5)

Do të hartohen rekomandime sipas standardeve më të mira evropiane.

Do të rishikohen rregulloret ekzistuese të koordinimit dhe marrëveshjet bashkëpunuese dhe të partneritetit të Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë.

Kalendari: muajt 3-5, 9

Aktiviteti 1.4: Mbështetje në hartimin e planit vjetor dhe shumë vjetor të biznesit të Dhomës Kombëtare të Përmbaimit.

Bazuar në vlerësimin financiar dhe human performuar në aktivitetin 1.3, do të vendosen objektiva zhvillimore afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë.

Mbi bazë të këtyre objektivave do të përpunohet dhe do t'u dërgohet palëve të interesuara një plan biznesi vjetor/strategji vjetore gjithashtu edhe një dokument i strategjisë 3- vjeçare.

Kalendari: muajt 3-5, 9

Aktiviteti 1.5: Mbështetje e një analize të shëndoshë buxhetore dhe kapaciteteve planifikuese të Ministrisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbaimit Shtetëror

Do të bëhet një vlerësim i kapaciteteve buxhetore dhe kapaciteteve planifikuese të Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbauesve Shtetërorë, për të identifikuar nevojat dhe dobësitë.

Zgjidhjet për të adresuar këto nevoja do të identifikohen bazuar në standartet evropiane, si dhe do të përcaktohet një metodologji e re për hartimin e analizave buxhetore dhe të planifikimit. Kjo metodologji e re do të prezantohet gjatë trajnimeve të shumta që do të zhvillohen për ngritjen e kapaciteteve, në kaudrin e projektit.

Një tavoline e rrumbullakët do të organizohet për t'i prezantuar rekomandimet të gjithë aktoreve të përfshirë në këtë proces, si dhe për të marrë miratimin e tyre.

REZULTATI 2. KOORDINIMI I SHËNDETSHËM NDËRINSTITUCIONAL DHE MEKANIZMAT E BASHKËPUNIMIT.

PËRBËRËSI 2: FUQIZIMI I KOORDINIMIT DHE BASHKËPUNIMIT NDËRINSTITUCIONAL.

Aktiviteti 2.1: Hartimi i procedurave bashkëkohore të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe mekanizmat e komunikimit ndërmjet Dhomës Kombëtare të Përmbartimit, Dhomës së Noterisë, Dhomës së Avokatëve, Dhomës së Tregtisë, Ministrisë së Brendshme, Bankave dhe si Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme)

Përshkrimi i aktivitetit:

Do të identifikohet dhe vlerësohet bashkëpunimi aktual dhe mekanizmat e komunikimit ndërmjet palëve të interesuara të përfshira në sistemin përmbartimor në Shqipëri (të përmendura më sipër).

Informacioni i ndjekur nga protokollat (mekanizmat e komunikimit, fazat etj) do të zhvillohen në mënyrë që të përmirësojë procesin e komunikimit ndërmjet tyre.

Bazuar në këtë rishikim, të gjitha propozimet e amendimeve për të lehtësuar marrëdhëniet midis palëve të interesuara (Ministrisë së Drejtësisë, Përmbartimit Publik etj) do t'i dërgohen Dhomës).

Kalendari: muaji 13.

Aktiviteti 2.2 Suporti mëtejshëm për zhvillimin e zgjidhjeve IT ndërinstitucionale ndërmjet përmbartuesve gjyqësorë dhe shërbimeve të bankave dhe pasurive dhe zgjerimi i përdorimit/implementimit të sistemit ALBIS (Regjistri elektronik i menaxhimit të çështjeve përmbartimore).

Përshkrimi i aktivitetit

Do të krijohet një diagram për të gjithë përdoruesit IT aktualë dhe potencialë të të gjitha palëve (përmbartues, dhe shërbimet e bankave dhe pasurive).

Do të vlerësohen zgjidhjet IT dhe do të bëhen rekomandimet e mëtejshme (software-t e transferimeve të të dish si, shitjeve në ankand elektronik, kompjuterizimi i akteve dhe proceseve, drejtoria elektronike)

Do të implementohen trajnime të përbashkëta në mënyrë që të forcohen kapacitetet e institucioneve në termat e zgjidhjeve IT të përbashkëta, duke përfshirë sistemin ALBIS dhe do të inkurajohen ata që nuk e përdorin, ta bëjnë këtë.

Kalendari:muaji 13

Aktiviteti 2.3 Forcimi i kapaciteteve të bashkëpunimit ndërinstitucional i Avokatit të Shtetit për të shtrirë ekzekutimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Përshkrimi i aktivitetit:

Do të vlerësohet bashkëpunimi aktual ndërinstitucional i Avokatit të Shtetit për sa i përket ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Bazuar në këtë vlerësim do të përgatiten draftet me rekomandime për të forcuar kapacitetet bashkëpunuese të Avokatit të Shtetit.

Kalendari: muajt 14-15

REZULTATI 3: SISTEME TRAJNIMI PROFESIONALE DHE KONTROLLI I PERFORMANCËS SË AGJENTËVE PËRMBARIMORË.

PËRBËRËSI 3: FORCIMI I PROFESIONALIZMIT TË AGJENTËVE PËRMBARIMORË DHE AKTORË TË TJERË BASHKËKOHORË.

Aktiviteti 3.1: Zhvillimi i një strategjie trajnimit dhe kurrikule për trajnime fillestare dhe të përkohshme të agjentëve përmbarimorë sipas standardeve evropiane. Mbështetjen e përgatitjeve respektive të materialeve bashkëkohore të trajnimit dhe drejtimit i radhës së trajnerëve.

Përshkrimi i aktivitetit

Do të mbahet një vlerësim i nevojave për trajnim në fazën e parë të projektit në mënyrë që të vlerësohen së bashku nevojat fillestare dhe vazhduese për trajnim.

Bazuar në këtë vlerësim, do të zhvillohet një kurrikulë e posaçme. Kurrikula do të përfshijë një set të plotë me material pedagogjik, duke përfshirë çështje studimore. E gjithë kurrikula do të përmbledhet në një manual trajnues për agjentët përmbarimorë dhe aktorët e tjerë aktualë.

Më pas do të vihet në zbatim trajnimi i trajnuesve.

Do të krijohet dhe monitorohet një bazë të dhënash e trajnuesve shqiptarë.

Do të identifikohet vendndodhja e përmbarimit në Shqipëri për të dhënë trajnime.

Kalendari:muajt 4-5

Aktiviteti 3.2: Zhvillimi i mekanizmave të monitorimit, kontrollit dhe inspektimit, duke përfshirë zbatimin më të mirë të sistemit ALBIS dhe check list-ën e kontrollit.

Përshkrimi i aktivitetit:

Do të hartohet një analizë globale e të gjithë aktorëve të përfshirë në këtë fushë dhe e sistemit të inspektimit dhe monitorimit.

Do të propozohet një sistem i plotë operativ monitorues si p.sh me monitorues rajonalë (duke përfshirë një përdorim më të mirë të ALBIS) së bashku me një set të plotë specifikimesh dhe check-lista e kontrollit.

Kalendari: muajt 5-6

Aktiviteti 3.3: Mbështetja e përmirësimit të statistikave të specifikimeve përmbljedhëse dhe performuese siç mund të jetë përmes sistemit ALBIS.

Përshkrimi i aktivitetit:

Ky aktivitet mund të implementohet në bashkërendim të aktivitetit 3.2

Do të hartohet një analizë globale e sistemit aktual të specifikimeve përmbljedhëse dhe performuese siç mund të jetë përmes sistemit ALBIS.

Bazuar në këtë analizë, do të propozohen edhe përmirësime.

Pritshmëria:

Raporti i analizës

Propozime për mekanizma të reja të statistikave përmbljedhëse dhe përmirësimi i specifikimeve të performancës.

Kalendari: muajt 6-7.

Aktiviteti 3.4: Vlerësimi i Kodit të Etikës, bazuar në Standardet Evropiane.

Përshkrimi i aktivitetit:

Do të bëhet një vlerësim i të gjithë rregullave dhe praktikave ekzistuese në fushën e kodit të etikës dhe rregulloreve të brendshme. Të gjithë dispozitat do të mblidhen, vlerësohen (sipas përputhshmërisë së tyre me standardet evropiane) dhe do të përshtaten nëse është e nevojshme.

Dispozitat e mbledhura dhe të përditësuara do të përmbledhen në kodet e etikës.

Kalendari: muajt 8-9

Aktiviteti 3.5 Zhvillimi i kurrikulës dhe menaxhimi i trajnimeve përsëritëse/vazhduese për agjentët përmbarimorë sipas standardeve evropiane.

Përshkrimi i aktivitetit

Bazuar në vlerësimin e nevojave për trajnim sipas aktivitetit 3.1, do të selektohen temat e trajnimit dhe do të zhvillohet një kurrikulë e cila përfshin materialin pedagogjik. Temat mund të përfshijnë daljen e kodit të ri të etikës të zhvilluar në aktivitetin 3.4.

Trajnimet e para do të mbahen nga ekspertë të BE, asistuar nga trajnerët e trajnuar sipas aktivitetit 3.1. Trajnimet e radhës do të implementohen nga trajnuesit lokalë, të ndihmuar nga ekspertë të BE. Kjo metodologji do të prevalojë në çdo sesion trajnimi.

Çdo trajnim do të bazohet në metoda moderne interaktive dhe do të përfshijë çështje studimore nga **praktika**.

Kalendari :muajt 5-6

Aktiviteti 3.6: Zhvillimi i kurrikulës dhe organizimi i trajnimeve të kombinuara të gjyqtarëve, agjentëve përmbarimorë dhe aktorë të tjerë sipas standardeve evropiane.

Përshkrimi i aktivitetit:

Do të hartohet një analizë e nevojave për trajnim, duke synuar zbatimin e trajnimeve për gjyqtarë, prokurorë dhe agjentë përmbarimorë si dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm mbi standardet kombëtare dhe evropiane në fushën e ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore.

Bazuar në analizën e nevojave, do të hartohet kurríkula, përfshirë një set të plotë me material pedagogjik.

Pas kësaj do të implementohen trajnime të kombinuara.

Kalendari: muajt 9-10, 14-15

Aktiviteti 3.7: Vizitë studimore

Përshkrimi i aktivitetit

Do të organizohet një vizitë studimore në shtetin anëtar të BE (Francë) mbi temën e metodologjisë së trajnimit për profesionistët përmbarimorë si dhe rregullave etike në Shkollën Kombëtare të Përmbarimit në Francë.

Kalendari: Muaji 13.

REZULTATI 4: ZGJERIMI I ZHVILLIMIT RAJONAL DHE PARAQITJA NË TERREN

PËRBËRËSI 4: PËRMIRËSIMI I PARAQITJES DHE ZHVILLIMIT RAJONAL.

Aktiviteti 4.1 Prezantimi i një sistemi të ri përmbartimor dhe aktiviteteve mbështetëse me qëllim zgjerimin e zhvillimit rajonal.

Përshkrimi i aktivitetit:

Do të organizohen seminare rajonale në 3 qytete kryesore të Shqipërisë për t'u prezantuar sistemin e ri përmbartimor të gjithë aktorëve të rëndësishëm.

Kalendari: muajt 13-16.

Aktiviteti 4.2. Përgatitja dhe implementimi i një strategjie ekspozimi përfshirë zhvillimin e një faqeje elektronike për Dhomën Kombëtare të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë.

Përshkrimi i aktivitetit:

Do të zhvillohet një strategji afatgjatë ekspozimi (përfshirë fushata mediatike, evente ekspozuese, krijimi i një faqeje elektronike për Dhomën Kombëtare etj)

Do të dizajnohet një faqe operacionale për Dhomën Kombëtare të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë.

Kalendari: muajt 5-6

Aktiviteti 4.3: Mbështetje për ndërgjegjësim, duke ndërmarrë veprime në Tiranë dhe rrethet.

Përshkrimi i aktivitetit:

Do të zhvillohen fushata mediatike në nivel rajonal dhe kombëtar për të rritur ndërgjegjësimin mbi Dhomën Kombëtare të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë dhe sistemit "të ri" të përmbartimit në popullsinë shqiptare.

Do të dizajnohen materiale publicitare/ekspozuese. Publikimi i broshurave/pamfleteve etj., mund të mbështetet nga projekti i binjakëzimit.

Kalendari: muajt 13-16

Aktiviteti 4.4: Vizitë studimore

Përshkrimi i aktivitetit

Do të organizohet një vizitë studimore në shtetin anëtar të BE (Francë) mbi praktikat më të mira në fushën e komunikimit dhe fushatave ekspozuese nëpër institucionet e përfshira në përmbardim.

Kalendari: muajt 6-7